



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

**I. NJOFTIMI I KONTRATËS QE PUBLIKOHET NË BULETININ E NJOFTIMEVE
PUBLIKE DHE NË FAQEN ZYRTARE TË AUTORITETIT KONTRAKTOR**

Seksioni 1 Autoriteti Kontraktor

1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Ministria e Mbrojtjes
Adresa Rr. e Dibrës, ish - Shkolla e Bashkuar, Tiranë, kutia postare 2423
Tel/Fax 042 226 601/2/3 1320, 1095
E-mail sekprokurime@mod.gov.al
Faqja e Internetit <http://www.mod.gov.al>

1.2 Lloji i autoritetit kontraktor

Institucion qendror	Institucion i pavarur
X	☐
Njësi e Qeverisjes Vendore	Tjetër
☐	☐

1.3 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një shteti tjetër:

Po	☐	Jo	X
----	--------------------------	-----------	----------

Seksioni 2 Objekti i kontratës

2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit: Urdhër Prokurimi nr. 2302, datë 03.11.2025, i titullarit të autoritetit kontraktor - Ministria e Mbrojtjes.

2.2 Lloji i “Kontratave për punë”

Realizimi i punëve	Projektimi dhe realizimi i punëve
X	☐

2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

Po	☐	Jo	X
----	--------------------------	----	---

2.4 Lloji i Marrëveshjes Kuadër

Me 1 operator ekonomik ☐

Me disa operatorë ekonomikë ☐

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po ☐ Jo ☐

Në Marrëveshjen Kuadër me 1 operator ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, të jepen arsyet e përzgjedhjes së kësaj lloji Marrëveshje Kuadër

--

2.5 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të përfundojë Marrëveshja Kuadër:_____ (Këtu duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër).

2.6	Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike.	
-----	---	--

2.7 Autoriteti kontraktor/Autoritetet kontraktore të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër:

2.8 Përshkrim i shkurtër i kontratës

1. Fondi limit: 731,994,696 (shtatëqind e tridhjetë e një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.
2. Burimi i Financimit: Shpenzimet për këtë procedurë të përballohen nga fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit për vitin 2025, në artikullin 231, projekti me kod 18AZ220.
3. Objekti i kontratës: "Ndërtimi i infrastrukturës së Bazës Ajrore Kuçovë (ndërtim i rrugës perimetrale, nënkallimi dhe fibra optike)", me vendndodhje Kuçovë.

2.9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Duke filluar nga data e fillimit të punimeve, me përfundim brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve.

2.9.1 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër

Kohëzgjatja në muaj: ose ditë: (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër (jo më shumë se (5) vjet)

Ose

duke filluar nga (dd/mm/vvvv)

Përfunduar më (dd/mm/vvvv)

2.10 Vendndodhja e objektit të kontratës: Kuçovë.

2.11 Ndarja në LOTE:

Po	☐	Jo	X
----	--------------------------	----	---

Nëse po,

2.12 Përshkrim i shkurtër i loteve

(Objekti dhe fondi limit i loteve)

1. _____

2. _____

3. _____

etj

Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.

2.13 Opsionet:

Numri i rinovimeve të mundshme (nëse ka): **Jo**

2.14 Zvogëlimi i numrit të kandidatëve të përshtatshëm (nëse aplikohet): **Jo**

2.14.1. Do të aplikohet zvogëlimi i numrit të kandidatëve të përshtatshëm, që do të ftohen:

Po	☐	Jo	X
----	--------------------------	----	---

2.14.2 Nëse do të aplikohet kriteri për zvogëlimin e numrit të kandidatëve:

i. Të specifikohet numri : _____

ii. Të specifikohen kriteret dhe rregullat që do të zbatohen për zvogëlimin e numrit të kandidatëve: _____

2.15 Do të pranohen variantet:

Po	☐	Jo	X
----	--------------------------	----	---

2.15.1 Do të pranohet nënkontraktimi:

Po	☐	Jo	X
----	--------------------------	----	---

Nëse do të lejohet nënkontraktimi, te specifikohet përqindja e lejuar për nënkontraktim: ____

Autoriteti kontraktor do t'i bëjë pagesa të drejtpërdrejtë nënkontraktorit:

Po	☐	Jo	☐
----	--------------------------	----	--------------------------

Shënime të tjera

2.16. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit: - Jo e aplikueshme.

2.17. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standardet janë të pa-aplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit: - Jo e aplikueshme.

Seksioni 3 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

3.1 Kriteret e Pranimit sipas Shtojcës 15.

Shënim: Referuar parashikimeve të LPFMS dhe nenit 28 të Rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, miratuar me VKM nr. 1170, datë 24.12.2020, pas mbylljes së fazës së para kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do të ftojë kandidatët e përzgjedhur/kualifikuar të njihen me dokumentet konkrete të tenderit ku përfshihen edhe kriteret e plota të pranimit, sipas Shtojcës 15.

3.2 Sigurimi i ofertës (i zbatueshëm në fazën e dytë).

Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare X

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente X

Seksioni 4 Procedura

4.1 **Lloji i procedurës:** Procedurë e kufizuar, e klasifikuar në nivelin “Konfidencial”.

Procedurë prokurimi e rishpallur :

Po	☐	Jo	X
-----------	--------------------------	----	----------

Nëse është procedurë e rishpallur të plotësohen të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:_____

a) Numri i referencës (*nr. datë i urdhërit të prokurimit*) të procedurës së prokurimit të anuluar:_____

b) Objekti i prokurimit të procedurës së prokurimi të anuluar:_____

c) Fondi limit i procedurës së prokurimit të anuluar:_____

Kjo procedurë prokurimi është e klasifikuar në nivelin “Konfidencial” dhe do të zhvillohet bazuar në:

- Ligjin nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”;
- Ligjin nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”;
- VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”;
- VKM nr. 659, datë 23.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”;

dhe përfshin dy faza kryesore:

Faza 1 - Parakualifikimi dhe përzgjedhja e kandidatëve:

Faza e parë (para kualifikimi) ka të bëjë me përzgjedhjen e kandidatëve, përpara dërgimit të ftesës për ofertë nga AK-ja. Para kualifikimi i ofertuesve është një proces i ndryshëm nga procedura e vlerësimit të ofertave, e cila përqendrohet në çmimin dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Procesi i para kualifikimit do të bëhet duke u përqendruar në vlerësimin e përvojës dhe aftësinë e kandidatëve për të zbatuar në mënyrë të kënaqshme kontratën konkrete. Qëllimi kryesor i para kualifikimit është përzgjedhja e atyre kontraktorëve/furnitorëve, kualifikimet dhe përvoja e të cilëve minimizon rrezikun e mosekzekutimit, sipas projektit/kontratës së propozuar.

Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në Fazën e Parë, janë përkatësisht si më poshtë:

I. Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin formularin e kërkesës për pjesëmarrje sipas formatit të dokumenteve të tenderit të publikuara nga APP në seksionin Legjislacioni / Prokurime në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

(<https://www.app.gov.al/legjislacioni/prokurimet-ne-fushen-e-mbrojtjes-dhe-te-sigurise/dst/>).

II. Kandidatët e interesuar duhet të jenë të pajisur me Certifikatën e Sigurimit Industrial (CSI), lëshuar nga AKSIK, e cila duhet të jetë:

- **Jo më e ulët se niveli i klasifikimit “Konfidencial”;**
- **E vlefshme në momentin e prokurimit dhe të lidhjes së kontratës së klasifikuar;**

Për këtë, ofertuesit duhet të paraqesin Certifikatë të Sigurimit Industrial, të lëshuar nga AKSIK, në emër të ofertuesit.

III. Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4; deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas Shtojcës 13; deklaratën mbi konfliktin e interesit, sipas Shtojcës 10 dhe deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës, sipas shtojcës 14, të dokumenteve të tenderit të publikuara nga APP, në seksionin Legjislacioni/ Prokurime në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, rubrika DST “Procedurë_e_Kufizuar_Punë”.

IV. Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin vërtetim se kanë paguar të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Ky vërtetim kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

V. Kandidatët e interesuar duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës, bazuar në formatin e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar.

Licenca profesionale e Operatorëve Ekonomikë lidhur me ekzekutimin e punëve objekt i kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- **N.P - 1 A** Punime gërmimi në tokë;
- **N.P - 4 G** Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale;
- **N.P - 5 B** Punime nentokesore, ura e vepra arti.
- **N.P - 7 A** Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje;
- **N.P - 11 A** Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e T/N e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- **N.P - 12 A** Punime te inxhinierisë se mjedisit.

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **N.S - 1 A** Punime per prishjen e ndertimeve;
- **N.S - 6 B** Sinjalistika rrugore jo ndricuese;
- **N.S - 8 A** Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri;
- **N.S - 10 D** Shtresa dhe mbistruktura speciale;
- **N.S - 18 E** Punime topogjeodezike.

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

- VI.** Kandidatët e interesuar duhet të jenë të pajisur me licensë lëshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.
- VII.** Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuar nga administrata tatimore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2022 - 2023 - 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.
- VIII.** Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin kopje të bilanceve të viteve financiare 2022, 2023 dhe 2024, të paraqitura në organet tatimore dhe të certifikuara/konfirmuara nga ana e këtyre organeve dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.
- IX.** Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2024 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2025.
- X.** Kandidatët e interesuar duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin:
 - a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së parashikuar të fondit limit të kontratës dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit;

- b) dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës së parashikuar të fondit limit të kontratës.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorëve Ekonomikë do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

- Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontratë sipërmarrje;
 - Formular vlerësimi;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore të situacionit përfundimtar, të deklaruara në organet tatimore;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Certifikatën e marrjes në dorëzim.
- Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :
 - Kontrate sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore të situacionit përfundimtar, të deklaruara në organet tatimore;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Certifikatën e marrjes në dorëzim.
- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontraten e bashkimit te operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet qe ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht duhet te paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor, shoqëruar me tabelën ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër nënkontraktori.

XI. Kandidatët e interesuar, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi me profil Transport	1 (një)
- Inxhinier Mekanik	1 (një)
- Inxhinier Elektrik	1 (një)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder	1 (një)
- Inxhinier Mjedisi	1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- kontratë pune të vlefshme, diplomën Universitare dhe listpagesat për periudhën e kërkuar. Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit.

XII. Në funksion të hartimit të ofertës dhe në kushtet kur ky proces kërkon akses tek informacioni i klasifikuar që administrohet nga Autoriteti Kontraktor, kandidatët e interesuar duhet të vërtetojnë se kanë personelin që plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar.

Për këtë, ofertuesit duhet të paraqesin :

- Dokumente/vërtetime ose CSI të lëshuara nga AKSIK në emër të ofertuesit, ku të evidentohet personeli i pajisur me CSP si më poshtë:
 - Administratori i shoqërisë;
 - Inxhinier ndërtimi;
 - Inxhinier elektrik;
 - Inxhinier elektronik.

Punonjësit si më sipër, janë kërkuar në funksion të përgatitjes së ofertës dhe zbatimit të kontratës pasi do të kenë akses në informacionin e klasifikuar lidhur me projektet e zbatimit, preventivat e punimeve, skica, planimetri, të dhëna dhe specifikime teknike, etj.

Në rast se gjatë zbatimit të kontratës, OE fitues do t'i lindë nevoja për angazhimin e punonjësve të tjerë, ka detyrimin që aksesin në informacionin e klasifikuar të bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në VKM nr. 659, datë 23.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”.

XIII. Kandidatët e interesuar, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë staf teknik dhe punonjës të specializuar/kualifikuar, si më poshtë:

- Inxhinier Elektronik	1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi (Profili Transport)	1 (një)
- Teknik Ndërtimi	2 (dy)
- Teknik Gjeodet (topograf)	1 (një)
- Teknikë/Specialistë të inxhinierisë elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit	2 (dy)
- Hidraulikë	2 (dy)
- Elektracistë	4 (katër)
- Hekurkthyes	5 (pesë)
- Karpentier	6 (gjashtë)
- Betonues dhe të tjerë që lidhen me to	6 (gjashtë)
- Punëtor ndërtimi dhe profesione të lidhura me to	10 (dhjetë)
- Hidroizolues	3 (tre)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

A) Për Inxhinierin elektronik dhe Inxhinierin e ndërtimit (Profili Transpot):

- kontratë pune të vlefshme;
- diplomën Universitare dhe listëpagesat për periudhën e kërkuar.

B) Për Teknikët e Ndërtimit dhe Teknikun Gjeodet (topograf):

- Kontratën individuale të punës;
- diplomën e shkollës së mesme profesionale përkatëse ose diploma bachelor në fushën përkatëse.

C) Për punonjësit e tjerë:

- Kontratën individuale të punës dhe
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas kësaj pike duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Tetor - Dhjetor 2025.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Tetor - Dhjetor 2025.

XIV. Kandidatët e interesuar duhet të përcaktojnë me anë të një deklarate nga (Administratori i shoqërisë), Përgjegjësin Teknik të Kantierit, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Përgjegjësi Teknik i Kantierit, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në nr. 448, datë 31.07.2005 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit”.

XV. Kandidatët e interesuar duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, shëndetit dhe sigurisë në punë, menaxhimit të mjedisit dhe sigurisë së informacionit. Për këtë duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- Certifikatë **ISO 9001:2015** ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- Certifikatë **ISO 45001:2023** ose ekuivalente mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim;
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.
- Certifikatë **ISO 27001:2022** ose ekuivalente mbi “Menaxhimin e sigurisë së informacionit”.

Certifikatat si më sipër duhet paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas natyrës së zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

XVI. Vetëdeklarim, sipas deklaratës në vijim, ku të evidentohen objektet dhe vlerat përkatëse të kontratave, nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100% i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “*periudhë*” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROÇES

(Për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese	Pergjegjesi i kantierit i deklaruar ne objekt

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Masa për sigurimin e informacionit të klasifikuar:

Në kushtet kur kontrata përmban informacion të klasifikuar, autoriteti kontraktor ka detyrimin që të kërkojë nga ofertuesit respektimin / përmbushjen e kriterëve për garantimin e këtij informacioni.

Për këtë ofertuesit duhet të paraqesin:

XVII. Një deklaratë noteriale (referuar nenit 39, të “Rregullores për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, miratuar me VKM nr. 659, datë 23.10.2024) ku të shprehin:

- a) angazhimin nga ofertuesi dhe nënkontraktorët për të ruajtur, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, sigurinë e informacionit të klasifikuar gjatë kohëzgjatjes së kontratës dhe pas zgjidhjes ose përfundimit të saj;
- b) angazhimin nga ofertuesi për të përmbushur detyrimet e parashikuara në shkronjën “a” për rastet e nënkontraktorëve të rinj, që do të identifikohen gjatë zbatimit të kontratës;
- c) të dhëna dhe informacion të mjaftueshëm për nënkontraktorët e propozuar, në mënyrë që autoriteti kontraktor të identifikojë nëse secili prej tyre ka aftësitë dhe kapacitetet e kërkuara për të garantuar, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, sigurinë e informacionit të klasifikuar, tek i cili ata do kenë akses ose të cilin do ta administrojnë gjatë kryerjes së aktiviteteve të nënkontraktuara;
- ç) angazhimin nga ofertuesi për të dhënë informacionin e kërkuar sipas shkronjës “c” për çdo nënkontraktor të ri, përpara se ta nënkontraktojë atë.

Kandidatët e interesuar për të marrë pjesë në procedurë duhet të dorëzojnë dokumentacionin në përputhje me kërkesat e përcaktuara si më sipër, në origjinal ose kopje të noterizuar, në një zarf të mbyllur, jo transparent, të nënshkruar dhe vulosur nga ana e tyre. Autoriteti Kontraktor, do të shqyrtojë dokumentet e dorëzuara nga operatorët ekonomikë dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës.

***Shënim:** Operatorët ekonomikë ofertues, janë të detyruar të garantojnë sigurinë e informacionit të marrë, duke i kthyer autoritetit kontraktor cdo dokumentacionin të tërhequr që përmban informacion të klasifikuar.*

Të gjithë dokumentat e kërkuara për fazën e parë të procedurës së prokurimit, duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos - dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Informacion i vlefshëm për ofertuesit lidhur me masat për mbrojtjen e sigorisë së informacionit të klasifikuar gjatë zhvillimit të procedurës dhe zbatimit të kontratës (referuar parashikimeve të LPFMS, RRPFMS dhe VKM nr. 659, datë 23.10.2024)

- Palët (AK dhe ofertuesit) kanë detyrimin që të përmbushin detyrimet e përcaktuara në Letrën e Aspekteve të Sigurisë (LAS), e cila përcakton masat e detyrueshme të sigorisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar nga faza e marrjes së konfirmimit të përputhshmërisë deri në fazën e nënshkrimit të kontratës.
- Palët (AK dhe Kontraktori), gjatë zbatimit të kontratës, janë të detyruara që të zbatojnë tërësinë e masave për sigurimin e informacionit të klasifikuar, sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi.
- Mospërmbushja e detyrimeve për zbatimin e kërkesave për sigurimin e informacionit të klasifikuar nga kontraktori apo nënkontraktori përbën shkak për zgjidhjen e njëanshme dhe të menjëhershme të kontratës së klasifikuar nga autoriteti kontraktor.
- Mospërmbushja e standardeve dhe e masave të sigorisë, të përcaktuara më parë në dakordësi me operatorët ekonomikë, në zbatim të një kontrate të klasifikuar, përbën shkak që autoriteti kontraktor të bëjë zgjidhjen e njëanshme dhe të menjëhershme të kësaj kontrate të klasifikuar.
- Nëse, gjatë zbatimit të kësaj kontrate të klasifikuar, kontraktori i hiqet CSI-ja nga autoriteti kompetent i sigorisë, autoriteti kontraktor bën zgjidhjen e njëanshme dhe të menjëhershme të kësaj kontrate të klasifikuar, në çdo fazë të zbatimit të saj.
- Në rastet kur, gjatë zbatimit të kontratës së klasifikuar, kontraktori i mbaron afati i vlefshmërisë së CSI-së dhe autoriteti kompetent i sigorisë nuk lëshon CSI për kontraktorin, autoriteti kontraktor bën zgjidhjen e njëanshme dhe të menjëhershme të kësaj kontrate të klasifikuar, në çdo fazë të zbatimit të saj.

Faza 2 - Ftesa për Ofertë dhe vlerësimi: Autoriteti Kontraktor do të dërgojë një ftesë për ofertë tek Kandidatët të cilët kanë plotësuar kërkesat për para-kualifikim duke i ftuar të dorëzojnë ofertat sipas përcaktimeve në DT dhe të specifikimeve të përcaktuara në ftesën për ofertë. Ofertat do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Autoriteti Kontraktor për të përcaktuar ofertën, fituese.

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit :

A) çmimi më i ulët X

Ose

B) oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

lidhur me rëndësinë: Çmimi ☐ ☐ **pikë**

etj. ☐ ☐ **pikë**

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

4.3 Afati kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:

Data : 02/02/2026 (dd/mm/vvvv) Ora : 10:00

Vendi: Ministria e Mbrojtjes, me adresë Rruga e Dibrës, Tiranë.

4.4 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: 180 (e shprehur në ditë)

4.5 Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip	X	Anglisht	X
Tjetër	_____		

Seksioni 5 Informacione plotësuese

5.1 Dokumenta me pagesë (ne rastet kur vlerësohet nga autoriteti kontraktor):

Po	☐	Jo	X
----	--------------------------	----	---

Nëse Po,

Monedha	_____	Çmimi	_____
---------	-------	-------	-------

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DT tek Operatorët Ekonomik. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DT para blerjes së tyre.

5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)

Referuar parashikimeve të LPFMS dhe nenit 28 të Rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, miratuar me VKM nr. 1170, datë 24.12.2020, dokumentet e tenderit do të vihen në dispozicion kandidatëve të përzgjedhur me qëllim hartimin dhe dorëzimin e ofertave për fazën e dytë të procedurës.

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi: **22/12/2025.**